

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DREJTIMI GJUHËSI

**ZHVENDOSJA E REGJISTRAVE TË TURQIZMAVE
NË GJUHËN SHQIPE**

PUNIMI I DOKTORATËS

Prishtinë, 2020

UNIVERSITY OF PRISHTINA "HASAN PRISHTINA"
FACULTY OF PHILOLOGY
DEPARTMENT OF LINGUISTICS

**REGISTER-SHIFTING OF TURKISMS IN ALBANIAN
LANGUAGE**

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2020

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË

DREJTIMI GJUHËSI

MA ZEQUIJE XHAFÇE

**ZHVENDOSJA E REGJISTRAVE TË TURQIZMAVE
NË GJUHËN SHQIPE**

PUNIMI I DOKTORATËS

Mentori:

Prof.dr. Abdulla Hamiti

Prishtinë, 2020

Rezyme

Struktura e punimit të disertacionit të doktoratës “Zhvendosja e regjistrave të turqizmeve përbëhet nga përbëhet nga dymbëdhjetë kapituj:

Kapitulli i parë trajton objektin, qëllimin, hipotezat dhe pyetjet e doktoratës. Qëllimi i këtij studimi është analiza e përdorimit të turqizmeve në regjistrat e gjuhës shqipe, identifikimi i funksioneve të tyre gjuhësore dhe përcaktimi i statusit gjuhësor të këtij leksiku. Ky është një studim i bazuar në të dhënat e vjela nga korpuset e vëllimit të madh, siç janë: Korpusi Nacional i Gjuhës Shqipe dhe Korpusi i krijuar nga intervistat e projektit të Historisë Gojore të Kosovës. Analizës i janë shtuar edhe nënkorpuse të tjera të nevojshme të cilat përfshijnë tekste të regjistrave të ndryshme, siç janë: këngët moderne, popullore, tekstet e reklamave etj., të cilët nuk janë të përfshirë në dy korpuset e lartpërmendura.

Hipotezat e studimit janë bazuar në paradigmen filozofike të pluralizmit funksional. Hipoteza e parë është se këto njësi gjuhësore janë shumëfunksionale, gjë që e vështirëson zëvendësimin e tyre me fjalë të tjera. Ky fenomen gjuhësor edhe pas spastrimit të gjuhës letrare i ruan apo i “(ri)kthen” ato në ligjërimin e shqipfolësve. Fakti që dy regjistra të rangut të gjerë, siç janë: gjuha e folur dhe gjuha e shkruar po mbivendosen, poashtu, e konfirmojnë një mundësi të tillë. Hipoteza e dytë është se ato janë zhvendosur në regjistrin joformal të gjuhës shqipe.

Kapitulli i dytë parashtron teorinë e metodologjisë dhe metodat e studimit. Kapitulli ndahet në dy nënkapituj sipas strategjisë së ndjekur. Në pjesën e parë bëhet parashtrimi dhe arsyetimi i metodologjisë së mbledhjes së të dhënave, mbledhja e të dhënave, teknikat dhe kriteret e përzgjedhjes së tyre. Në pjesën e dytë është dhënë përshkrimi lingvistik dhe sociolingvistik i përmbajtjes së dy korpuseve kryesore të studimit. Në fund bëhet prezantimi i metodës së përzier (mixed method) në kuadër të nënkapitullit “Dizjani i hulumtimit”.

Kapitulli i tretë prezanton sfondin teorik të përgjithshëm në të cilin mbështetet ky studim. Ndahet në dy nënkapituj kryesorë, secili prej të tyre trajton fusha të ndryshme teorike të ndërlidhura. Në nënkapitullin e parë parashtrohet funksionalizmi si paradigme filozofike e studimit dhe studimet paraprake të bëra në fushën e studimit të turqizmeve, me ç’rast përpiqemi të parashtrojmë, paralelisht, paradigmen filozofike të këtij studimi dhe të studimeve kyçe të kësaj fushe. Nënkapitulli i dytë trajton zhvillimin sociologjik dhe historik të dy popujve dhe gjuhëve të tyre në kontakt. Po ashtu, trajton shtrirjen dhe statusin e gjuhës shqipe dhe turke gjatë historisë. Këtij kapitulli i është bashkëngjitur edhe nënkapitulli tjetër që trajton ndërdikimet gjuhësore në gjuhën e shkruar gjatë periudhës së Perandorisë Osmane në këto troje, ku me theks të veçantë parashtrohet problemi i gjuhës së letërsisë alamiado shqiptare.

Kapitulli i katërt shtjellon çështjen e statusit të turqizmave në leksikologjinë dhe leksikografinë e gjuhës shqipe. Pas shqyrtimit të mendimeve dhe qëndrimeve të studiuesve të deritanishëm lidhur me statusin e turqizmave në leksikostilistikën e gjuhës shqipe. Kapitulli vazhdon me analizën e ndarë në dy periudha: në periudhën kur kontaktet gjuhësore ende vazhdonin dhe në periudhën e dytë kur ato më ishin ndërprerë. Statusi i turqizmave në leksikologjinë e gjuhës shqipe trajtohet edhe më tej në kapitullin vijues, ku trajtohen proceset semantike të huazimeve, kontekst ky në të cilin mund të shihet më qartë roli i tyre në leksikostilistikën e gjuhës shqipe.

Për ta mbuluar leksikografinë e gjuhës shqipe janë trajtuar turqizmat e disa fjalorëve në kaptuj të veçantë: 1. Fjalori i Gjuhës Shqipe që është botuar për herë të parë në vitin 1980 dhe sot e kësaj dite zgjerohet dhe përpunohet në formën elektronike; 2. Fjalori i fjalëve të huaja në gjuhën shqipe të botuar në vitin 2017 nga Botimet Toena, ku është përfshirë një numër i madh i turqizmave të pa regjistruara në FGJSSH; 3. Fjalori i orientalizmave të gjuhës shqipe të Tahir Dizdarit të botuar në vitin 2005 në Tiranë, si vepër më e vëllimshme, e cila përmban një korpus të madh të turqizmave prej më shumë se 4000 njësisish leksikore; 4. Fjalori sinonimik i gjuhës shqipe, ku trajtohet prania e turqizmave si fjalë e parë dhe sinonimim i fjalës shqipe; si dhe 5. Fjalori i të folmeve të arbanasve të Zarës, të botuar me vitin 1987 për ta përfshirë statusin e turqizmave të popullit shqiptar të shpërngulur në shekullin XVII, periudhë kjo në të cilën mendohet se turqizmat kanë filluar të depërtojnë me një hov të madh.

Kapitulli i pestë trajton teorinë e kontakteve gjuhësore me theks të veçantë huazimin dhe procesin e huazimit gjuhësor. Këtu i kemi përfshirë teoritë më të vjetra mbi të cilat mbështeten shumica e studimeve të huazimeve, siç është studimi i Weinreich-ut i vitit 1953, si dhe ato më të rejat, të cilat i janë qasur këtij fenomeni nga aspekte të tjera, siç janë: Matras (2009), Winford (2003) etj. Po ashtu, është bërë krahasimi i mendimeve të strukturalistëve dhe sociolinguistëve, të cilët konstatojnë se qëndrimi, pakësimi dhe mbijetesa e huazimeve varet nga faktorët shoqërorë, e jo nga struktura e gjuhëve në kontakt. Procesi i huazimit të turqizmave të vjela nga korpusi i KNGJSH-së është analizuar sipas teorisë së gjuhëve në kontakt të Filipoviç-it, i cili ka punuar në zhvillimin e mëtejshëm të teorisë së Haugen-it dhe Weinreich-ut. Për nevoja të analizës së turqizmave nga aspekte të morfostilistikës dhe leksikostilistikës, në nënkapitujt të veçantë është bërë analiza e tyre gjatë procesit të përshtatjes morfologjike si dhe gjatë proceseve leksiko-semantike dhe sintaktike-stilistike-semantike. Nënkapitulli i parë është klasifikuar sipas llojeve të fjalëve, prapashtesave të huazuara dhe pseudohuazimeve. Nënkapitujt në vazhdim i parashetrojnë analizat e turqizmave nga aspekti semantik, ku përfshihen leksemat dhe shprehjet frazeologjike të gjuhës shqipe.

Kapitulli i pestë me interesim të veçantë e trajton edhe leksikalizimin e ngjyrave të gjuhës shqipe. Ky është një proces ku turqizmat si huazime dhe sinonime luajnë rol të rëndësishëm në zbardhjen e dy teorive kryesore të ngjyrave (universaliste dhe relativiste), për shkak të përdorimit të tyre në regjistra apo stile të ndryshme funksionale të cilat edhe janë objekti kryesor i këtij studimi.

Kapitulli i gjashtë me titullin “Analiza e turqizmave në regjistra të shqipës” përfshin analizën e përdorimit të turqizmave të vjela në korpuset e teksteve bashkëkohore të gjuhës shqipe, duke u përpjekur që të mbrohen hipotezat e këtij studimi. Kapitulli parashtron sfondin teorik të studimeve të regjistrave dhe stilit. Këtu trajtohen regjistra të ndryshëm të diapazonit të gjerë të një folësi. Pra, bëhet ndarja e regjistrave të përgjithësimit të lartë, siç janë: regjistri i shkruar dhe regjistri i folur.

Në kapitullin e shtatë analizohen struktura e korpusit të teksteve me regjistra të gjuhës së shkruar (KNGJSH) si dhe e korpusit të teksteve me regjistra të gjuhës së folur shqipe (HGK etj.).

Kapitulli i tetë trajton përdorimin e turqizmave në dy korpuset të lartpërmendura sipas regjistrave dhe stileve të ndryshëm. Këtu bëhet vlerësimi pranueshmërisë së turqizmave në KNGJSH, krahasimi i dendësisë së përdorimit të tyre sipas periudhave kohore si dhe analiza e dendësisë së përdorimit të turqizmave në raport me sinonimiket e tyre. Vëllimi dhe larmia e korpusëve mundësoi edhe analizën e pranisë së turqizmave në regjistra të përgjithësimit të ulët, siç janë: tekste të gazetave, romaneve, shkrimeve akademike, dokumenteve zyrtare, tekstet e reklamave, tekstet e këngëve etj. Turqizmat e vjela nga këto regjistra të gjuhës shqipe janë analizuar sipas përzgjedhjes dhe përdorimit të tyre nga ana e shqipfolësve. Në kapituj të veçantë janë ilustruar me kontekstin e tyre shembujte turqizmave të përdorura në regjistra apo stile funksionale (me terminologjinë e përdorur nga Rugova & Sejdiu-Rugova, 2015) të cilët janë klasifikuar sipas orientimit të folësit. Analiza përfshin stile të orientuara sipas raportit me bashkëbiseduesin të cilët ndahen sipas nivelit të formalitetit, për t’u përgjigjur në pyetjen se a janë zhvendosur turqizmat nga regjistri i lartë në regjistrin e ulët. Përveç kësaj, janë analizuar edhe stilet e orientuara nga funksioni shprehës, funksioni nxitës, si dhe funksioni i informimit. Stilet e orientuara nga funksioni shprehës janë ndarë në stilin ironik, stilin metaforik dhe stilin hiperbolik, të cilët zakonisht hasen në regjistra të nivelit të ulët të formalitetit. Stilet e orientuara nga funksioni nxitës janë stili vlerësues, stili zhvlerësues dhe stili bindës, e që shtrihen në të gjithë rangun e regjistrave. Stilet e orientuara nga informimi janë ndarë në dy: stili teknik dhe stili ilustrues-krahasues, të cilët më shumë shtrihen në regjistra të rangut të lartë. Në nënkapitullin e nëntë trajtohen turqizma të nën-korpusëve të regjistrave të ultë të formalitetit.

Ndërsa në kapitullin e radhës jemi përpjekur të përfshijmë disa regjistra të nivelit të ultë të formalitetit, siç janë tekstet e disa zhanrave të muzikës shqiptare, tekstet e shkurta të mesazheve publike, reklamave dhe titujve të gazetave si dhe tekprograme televizive ku është bërë analiza e përdorimit të turqizmave dhe funksionalizimit apo instrumentalizimit të tyre.

Në nënkapitullin e veçantë analizohet përdorimi i turqizmave të propozuara për zëvendësim me fjalët shqipe nga Projekti “Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj”. Po ashtu, është parë shtrirja dhe përhapja e tyre nëpër regjistra dhe stile të ndryshme, të cilat janë ilustruar me shembuj në kontekst të nxjerrë nga korpuset mbi të cilat bazohet studimi ynë.

Në kapitullin e parafundit, ose kapitullin XII bëhet analiza e emrave turke personale ku është matur prania e tyre sipas moshës së personave.

Secili kapitull është strukturuar në mënyrë të veçantë dhe përmban hyrje, nënkapituj dhe përfundim. Në fund parashtrohen interpretimi i përfundimeve të nxjerra nga analizat e bëra. Studimi i përfshin këto shtojca: 1.Listën e turqizmave të vjela nga korpusi i KNGJSH-së, ku janë markuar : a. dendësia e përdorimit; b.markimi leksikografik i turqizmave; c.markimi i përdorimit të turqizmave sipas stileve funksionale; 2.Listën e turqizmave me zero përdorim të vjela nga fjalorët e lartpërmendur; 3.Listën e turqizmave që krijojnë çerdhje fjalësh; 4.Listën e turqizmave të përfshira në frazeologjinë e gjuhës shqipe; 5.Listën e të dhënave sociolinguistike të folësve të korpuseve të gjuhës së folur, si dhe distribuimi i turqizmave sipas individëve të intervistuar.

Summary

The doctoral dissertation “Register-Shifting of turkisms in Albanian Language” consists of twelve chapters:

The first chapter deals with the object, purpose, hypotheses and questions of the doctoral dissertation. The purpose of this study is to analyze the use of turkisms in the registers of the Albanian language, to identify their linguistic functions and to determine the linguistic status of this lexicon. This is a corpus-based study based on data collected from large-volume corpora of texts, such as: the Albanian National Language Corpus and the corpus of spoken Albanian which is created from the interviews conducted in the frame of Kosovo Oral History project. Other necessary sub-corpora include texts from various registers, such as: song texts, advertisement texts, tweets, TV shows etc., which are not included in the two aforementioned corpora.

Study hypotheses are based on the philosophical paradigm of functional pluralism. The first hypothesis is that these linguistic units are multifunctional, which makes it difficult to replace them with other words. This linguistic phenomenon, even after the purification of the literary language, preserves or returns them into usage in the discourse of Albanian speakers. The fact that two wide-ranging registers, such as spoken language and written language, are overlapping, also confirms such a possibility. The second hypothesis is that they have been moved to the informal register of the Albanian language.

The second chapter presents the theory of methodology and methods applied to this study. The chapter is divided into two subchapters according to the followed strategy. The first part presents and justifies the data collection methodology, data collection, techniques and selection criteria. In the second part, the linguistic and sociolinguistic description of the content of the two main corpora is given. At the end, within the sub-chapter "Research Design" the mixed method is presented.

The third chapter presents the general theoretical background on which this study is based. Divided into two main subchapters, each of them deals with different interrelated theoretical fields. The first sub-chapter presents functionalism as a philosophical paradigm of study and preliminary studies in the field of study of turkisms. The second sub-chapter deals with the sociological and historical development of two different languages in contact. It also addresses the extent and status

of the Albanian and Turkish languages throughout history. Attached to this chapter is another sub-chapter that deals with linguistic interactions in the written language during the period of the Ottoman Empire in this region, with special focus on the problem of Albanian aljamiado literature.

The fourth chapter discusses the issue of the status of turkisms in the lexicology and lexicography of the Albanian language. After reviewing the opinions and attitudes of researchers regarding the status of turkisms in the lexical-stylistics of the Albanian language the chapter continues with the analysis divided into two periods: the period when language contacts were still ongoing and the second period when contact was interrupted. The status of turkisms in the lexicology of the Albanian language is further addressed in the following chapter, where the semantic processes of these borrowings are treated, a context in which the role of turkisms in the lexicology and stylistics of the Albanian language can be observed more clearly.

To cover the lexicography of the Albanian language, the turkisms of these dictionaries are treated: 1. The Dictionary of the Albanian Language, which was first published in 1980 and to this day is expanded and processed in online form; 2. Dictionary of foreign words in the Albanian Language published in 2017 by Botimet Toena, which includes a large number of un-registered Turkisms in the dictionary of 1980; 3. The Dictionary of Orientalisms of the Albanian Language by Tahir Dizdari published in 2005 in Tirana, as the most voluminous work, which contains a large corpus of turkisms of more than 4000 lexical items; 4. The Dictionary of the Synonyms of Albanian Language, which deals with the presence of turkisms as the first lexical unit and as a synonym of other Albanian words; as well as 5. Dictionary of the Dialect of the Albanians of Zadar, published in 1987 to include the status of the turkisms of the Albanian people displaced in the seventeenth century, a period in which it is thought that turkisms have begun to penetrate with great momentum.

The fifth chapter deals with the theory of linguistic contacts with special emphasis on borrowing and the process of linguistic borrowing. Here we have included the older theories on which most borrowing studies are based, such as Weinreich's 1953 study, as well as the newer ones, which have approached this phenomenon from other aspects, such as: Matras (2009), Winford (2003) et al. Also, the opinions of structuralists and sociolinguists have been compared, who find that the attitude, reduction and survival of borrowings depends on social factors, and not on the structure of languages in contact. The process of lexical borrowing of turkisms registered in the corpora ANC is studied in the framework of Filipovic's theory of contact languages, who

worked on the further development of Haugen's and Weinreich's theory. Turkisms are also analyzed in both contexts of morphostylistics and lexicostylistics. In special sub-chapters the analysis of the process of morphological adaptation and lexico-semantic and syntactic-stylistic-semantic adaptation is done. The first sub-chapter is classified according to the types of words, borrowed suffixes and pseudo-borrowings. The following sub-chapters present the analysis of turkisms from the semantic point of view, which includes lexemes and phraseological expressions of the Albanian language.

The fifth chapter also deals with the lexicalization of the colors of the Albanian language. This is a process where turkisms as borrowings and synonyms play an important role in understanding and uncovering the two main color theories (universalist and relativist), due to their use in various functional registers or styles.

The sixth chapter, "Analysis of turkisms in Albanian Registers" includes the analysis of the use of obsolete turkisms in the corpora of contemporary Albanian language texts, trying to defend the hypotheses of this study. The chapter sets out the theoretical background of register and style studies. Here are treated different registers of a wide range of a Albanian speaker. So, registers of high level of generalization such as the written register and the spoken register, are observed.

In the seventh chapter, the structure of the corpus of texts with registers of written language (Albanian National Corpus- new version of 2019/ANC) as well as the corpus of texts with registers of Albanian spoken languages (*Historia Gjoje e Kosovës* project etc.) are analyzed.

Chapter eight deals with the use of turkisms in the two aforementioned corpora according to different registers and styles. Here is the quantitative analysis and assessment of the presence of turkisms in ANC, the comparison of the density of their use according to the time periods as well as the analysis of the density of the use of turkisms in relation to their synonyms. The volume and variety of corpora also enabled the analysis of the presence of turkisms in low generalization registers, such as: newspaper texts, novels, academic writings, official documents, advertising texts, song lyrics, etc.

The turkisms collected from these registers have been analyzed based on language choices of Albanian speaker in different contexts and situations. In separate chapters turkisms are classified according to registers and functional styles (with the terminology used by Rugova & Sejdiu-Rugova, 2015) in which they have been detected. Each style is illustrated with examples. In order

to answer the question of whether the turkisms have been moved from the high register to the low register the analysis includes styles oriented according to the relationship with the interlocutor who are divided according to the level of formality. The usage of turkisms in styles oriented by expressive function, stimulative function, and informative function were analyzed. Expressive function-oriented styles are divided into ironic style, metaphorical style, and hyperbolic style, which are commonly encountered in low-level formality registers. Stimulus-oriented styles are the appraisal style, the devaluation style, and the persuasive style, which extends across the register range. Information-oriented styles are divided into two: technical style and illustrative-comparative style, which are more prevalent in high-ranking registers.

The ninth sub-chapter deals with the turkisms of the sub-corpora of the registers of a lower level of formality, such as the texts of some genres of Albanian music, short texts of public messages, advertisements and newspaper headlines as well as TV shows where the analysis of their functionalization or instrumentalisation is conducted.

In the special subchapter, the turkisms that have been proposed for replacement with Albanian words by the Project "Fjala shqipe në vend të fjalës së huaj" are reviewed. Their spread and distribution in different registers and styles has been detected and illustrated with examples in the context derived from the corpus on which our study is based.

The last chapter deals with the analysis of personal Albanian names with Turkish origin. The presence and density of these nouns is measured according to the age of the persons.

Each chapter is structured separately and contains introduction, subchapters, and conclusion. At the end, the interpretation of the conclusions drawn from the analyzes is presented.

The study includes the following annexes: 1. List of turkisms collected from the ANC corpus, which are marked by these criteria: a. density of use; b. lexicographical marking of turkisms; c. marking of functional styles in which they are used; 2. The list of turkisms with zero-usage; 3. List of turkisms as root words and other words formed on its basis ; 4. List of turkisms included in the phraseology of the Albanian language; 5. List of sociolinguistic data of the speakers of the corpora of the spoken language, as well as the quantitative data about the distribution of turkisms according to the interviewed individuals.

